Funded by
the European Union

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 9- 180/625
Nr. i faq. 3
Data 26/01/2026

PROCESVERBAL

Takim informues në kuadër të projektit "EFFORT"

Të dhëna të përgjithshme

Takimi informues është mbajtur më 21.01.2026, në kuadër të projektit "EFFORT", për thirrjen publike të datës 26.12.2025, me titull:
"Punime ndërtimore për zbatimin e masave të efiçiencës së energjisë (EE) për ndërtesat publike, në kuadër të projektit EFFORT".

Takimi është organizuar në përputhje me pikën 13.1.11 të Dokumentit të Tenderit, Vëllimi 1, Seksioni 1 – Udhëzime për Ofertuesit, si dhe në përputhje me kërkesat e procedurave PRAG.

Fillimi dhe rrjedha e takimit

Takimi ka filluar në ora 10:00, me Koordinatorin e Projektit dhe përfaqësuesit e kompanisë projektuese "Studio Links 4", si pjesë e përgatitjeve për pritjen e operatorëve ekonomikë të interesuar.

Pjesëmarrësit

Në takim morën pjesë: Demokrat Ganijaj – Koordinator i Projektit "EFFORT", Përfaqësues të kompanisë projektuese "Studio Links 4", Znj. Nafije Gashi, Z. Kadrush Latifi

Nga ora 11:00, takimi u hap zyrtarisht për kompanitë ofertues.
Në ora 11:15, takimit iu bashkuan operatorët ekonomikë si më poshtë:
1. ARCUM STUDIO SHPK
2. NPSH Consult ENG
3. U – UNIQUE SHPK

Qëllimi i takimit

Qëllimi i takimit ishte ofrimi i udhëzimeve, sqarimeve teknike dhe informatave të përgjithshme për operatorët ekonomikë lidhur me thirrjen publike të datës 26.12.2025, si dhe sqarimi i procedurave të aplikimit, në përputhje me dokumentacionin e tenderit.

Prezantimi dhe njoftimet hyrëse

Takimin e hapi Koordinatori i Projektit, z. Demokrat Ganijaj, i cili fillimisht u prezantua para të pranishmëve dhe u uroi mirëseardhje operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.
Më pas, të pranishmëve iu shpërnda lista për nënshkrime dhe filloi prezantimi i qëllimit të takimit dhe ecurisë së projektit "EFFORT".

Koordinatori njoftoi se për takimin do të mbahej procesverbal zyrtar, i cili do t'u shpërndahej të gjithë pjesëmarrësve dhe se bashkëngjitja e këtij procesverbali në dokumentacionin e ofertimit është obligative, në përputhje me procedurat PRAG, duke theksuar se mospërfshirja e tij përbën bazë për eliminim nga procedura e tenderimit.

Pas fjalës hyrëse, fjala iu dha përfaqësuesve të kompanisë projektuese "Studio Links 4", Znj. Nafije Gashi e cila prezantoi aspektin teknik dhe profesional të projektit "EFFORT", duke sqaruar llojin e punimeve që do të realizohen, objektet publike ku do të zhvillohen punimet dhe elementet kryesore teknike të ndërhyrjeve të planifikuara.
Më pas, takimi u hap për pyetje dhe diskutime me operatorët ekonomikë të pranishëm.

Pyetje dhe sqarime nga operatorët ekonomikë

Përfaqësuesi i "ARCUM STUDIO SHPK" parashtroi pyetje lidhur me procedurën e pajisjes me leje nga KEDS, konkretisht se kush do të bëjë aplikimin për pajisje me leje.
Përgjigje: Koordinatori i Projektit, z. Ganijaj, sqaroi se kompania fituese do të hartojë projektin teknik, ndërsa Komuna e Junikut do të aplikojë për licencim.

Gjithashtu u parashtrua pyetje nëse, në rast se punimet nuk arrijnë të kryhen brenda afatit të kontratës, mund të ketë vazhdim të afatit.
Përgjigje: Koordinatori sqaroi se afati i projektit "EFFORT" është 36 muaj, dhe të gjitha procedurat, punimet, testimet dhe pranimet teknike duhet të përfundojnë deri në muajin tetor, pa mundësi shtyrjeje të afatit.

Përfaqësuesi i "NPSH Consult ENG" parashtroi pyetje lidhur me vonesat eventuale nga KEDS.
Përgjigje: Koordinatori njoftoi se që nga fillimi i projektit janë zhvilluar takime koordinuese me institucionet relevante (KEDS, ZRRE, KESCO, etj.) dhe është marrë zotim që kërkesat lidhur me projektin "EFFORT" të trajtohen me prioritet.

Përfaqësuesi i "U – UNIQUE SHPK" parashtroi pyetje lidhur me afatin kohor për pajisje me licencë nga ZRRE.
Përgjigje: Përfaqësuesja e kompanisë projektuese, znj. Gashi, sqaroi se Bordi i anëtarëve të ZRRE-së mblidhet çdo muaj dhe se brenda 30 ditëve pritet përgjigje për kërkesat e paraqitura.

Vizitat në terren

Koordinatori I projektit z. Ganijaj njoftoi se vizitat në terren ishin të planifikuara si opsionale. Operatorët ekonomikë shprehën interesim për vizitë në Objektin e Komunës së Junikut dhe Objektin e QKMF-së, pasi në këto objekte investimet janë më të mëdha dhe më komplekse.

Gjatë vizitës në objektin e Komunës së Junikut, nga përfaqësuesi i kompanisë projektuese z. Kadrush Latifi u sqaruan punimet e planifikuara, përfshirë: vendosjen e pompave termike, ndërrimin e dyerve hyrëse dhe dritareve në të gjithë objektin, punimet në Sallën e Kuvendit Komunal dhe instalimin e roletave me komandë.

Gjatë kësaj vizite, "U – UNIQUE SHPK" parashtroi pyetje lidhur me furnizimin me energji elektrike të roletave në Sallën e Kuvendit Komunal.
Përgjigje: Z. Latifi sqaroi se ekziston mundësi teknike për realizim, pasi afër dritareve ka priza elektrike.

Vizita në QKMF u realizua në prani të Drejtorit z. Ali Kuqi, i cili vlerësoi rëndësinë e projektit.

Gjatë vizitës, "NPSH Consult ENG" parashtroi pyetje lidhur me tejkalimin e buxhetit të planifikuar.
Përgjigje: Koordinatori sqaroi se në rast tejkalimi të buxhetit nga një operator ekonomik, ai operator eliminohet nga procedura, ndërsa në rast tejkalimi nga të gjithë operatorët, procedura e tenderimit anulohet, pasi buxheti është i përcaktuar dhe nuk mund të tejkalohet.

U parashtrua gjithashtu pyetje nëse gjatë punimeve institucionet kanë magazina për vendosjen e materialit.
Përgjigje: Institucionet nuk kanë magazina. Materialet që nuk dëmtohen nga shiu apo lagështia mund të vendosen në oborret e institucioneve, pasi objektet janë të pajisura me kamera sigurie, ndërsa materialet e ndjeshme ndaj shiut dhe lagështisë mund të vendosen në hapësirat e brendshme të objekteve (korridore), pa penguar lëvizjen e njerëzve.

Përfundimi i takimit

Pas përfundimit të vizitave në terren, Koordinatori i Projektit dhe përfaqësuesit e kompanisë projektuese qëndruan në lokacionin e Komunës së Junikut deri në ora 16:00, sipas planifikimit. Deri në këtë orë nuk u paraqit asnjë operator tjetër ekonomik dhe takimi u mbyll zyrtarisht.

Procesverbalin e përpiloi:
Ilirjana Isufaj

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 9 - 180/625
Nr. i faq. 3
Data 26/01/2026

# MINUTES OF MEETING

Information Meeting within the "EFFORT" Project

## 1. General Information

The information meeting was held on 21 January 2026, within the framework of the "EFFORT" Project, regarding the public call dated 26 December 2025, entitled:

"Construction Works for the Implementation of Energy Efficiency (EE) Measures for Public Buildings, within the EFFORT Project."

The meeting was organized in accordance with point 13.1.11 of the Tender Dossier, Volume 1, Section 1 – Instructions to Tenderers, as well as in compliance with PRAG procedures.

## 2. Opening and Course of the Meeting

The meeting commenced at 10:00, with the participation of the Project Coordinator and representatives of the design company "Studio Links 4", as part of the preparations for receiving interested economic operators.

## 3. Participants

The following participants attended the meeting:
- Demokrat Ganijaj – Project Coordinator, "EFFORT"
- Representatives of the design company "Studio Links 4"
- Ms. Nafije Gashi
- Mr. Kadrush Latifi

At 11:00, the meeting was officially opened for the bidding companies.

At 11:15, the following economic operators joined the meeting:
1. ARCUM STUDIO SHPK
2. NPSH Consult ENG
3. U – UNIQUE SHPK

## 4. Purpose of the Meeting

The purpose of the meeting was to provide guidance, technical clarifications, and general information to economic operators regarding the public call dated 26 December 2025, as well as

to clarify application procedures in accordance with the tender documentation.

5. Presentations and Introductory Announcements

The meeting was opened by the Project Coordinator, Mr. Demokrat Ganijaj, who introduced himself to the participants and welcomed the attending economic operators.

Subsequently, the attendance list was distributed for signatures, and a presentation was delivered on the purpose of the meeting and the progress of the "EFFORT" Project.

The Coordinator informed participants that official minutes would be prepared for the meeting and distributed to all participants. He emphasized that attachment of these minutes to the tender documentation is mandatory, in accordance with PRAG procedures, and that failure to include them constitutes grounds for elimination from the tendering procedure.

6. Technical Presentation

Following the introductory remarks, the floor was given to the representatives of the design company "Studio Links 4".

Ms. Nafije Gashi presented the technical and professional aspects of the "EFFORT" Project, explaining the type of works to be implemented, the public buildings where the works will take place, and the main technical elements of the planned interventions.

The meeting was then opened for questions and discussions with the attending economic operators.

7. Questions and Clarifications from Economic Operators

The representative of ARCUM STUDIO SHPK raised a question regarding the procedure for obtaining permits from KEDS, specifically asking who would be responsible for submitting the application.

Response:
The Project Coordinator, Mr. Ganijaj, clarified that the winning company will prepare the technical design, while the Municipality of Junik will apply for licensing.

A further question was raised regarding whether an extension of the contract deadline would be possible if works could not be completed within the contractual timeframe.

Response:
The Coordinator clarified that the duration of the "EFFORT" Project is 36 months, and that all procedures, works, testing, and technical acceptance must be completed by October, with no

possibility of deadline extension.

The representative of NPSH Consult ENG raised a question regarding potential delays by KEDS.

Response:
The Coordinator informed participants that coordination meetings have been held since the beginning of the project with relevant institutions (KEDS, ERO, KESCO, etc.), and that commitments have been obtained to treat requests related to the "EFFORT" Project as a priority.

The representative of U – UNIQUE SHPK raised a question regarding the timeframe for obtaining licensing from ERO (ZRRE).

Response:
The representative of the design company, Ms. Gashi, clarified that the ERO Board meets on a monthly basis, and that a response to submitted requests is expected within 30 days.

8. Site Visits

The Project Coordinator, Mr. Ganijaj, informed participants that site visits were planned as optional.

Economic operators expressed interest in visiting the Municipality of Junik Building and the Main Family Medicine Center (QKMF), as these buildings involve larger and more complex investments.

During the visit to the Municipality of Junik building, the representative of the design company, Mr. Kadrush Latifi, explained the planned works, including:

- Installation of heat pumps
- Replacement of entrance doors and windows throughout the building
- Works in the Municipal Assembly Hall
- Installation of electrically controlled roller shutters

During this visit, U – UNIQUE SHPK raised a question regarding the power supply for the roller shutters in the Municipal Assembly Hall.

Response:
Mr. Latifi clarified that there is a technical possibility for implementation, as electrical sockets are located near the windows.

The visit to the QKMF was conducted in the presence of the Director, Mr. Ali Kuqi, who emphasized the importance of the project.

During the visit, NPSH Consult ENG raised a question regarding the possibility of exceeding the planned budget.

Response:
The Coordinator clarified that if a single economic operator exceeds the budget, that operator will be eliminated from the procedure, while if all operators exceed the budget, the tender procedure will be cancelled, as the budget is fixed and cannot be exceeded.

A further question was raised regarding the availability of storage facilities for materials during the execution of works.

Response:
The institutions do not have warehouses. Materials that are not sensitive to rain or humidity may be stored in the institutional courtyards, as the buildings are equipped with security cameras, while materials sensitive to rain and humidity may be stored in internal spaces (corridors), provided they do not obstruct the movement of people.

9. Conclusion of the Meeting

After completion of the site visits, the Project Coordinator and representatives of the design company remained at the Municipality of Junik premises until 16:00, as planned.

No additional economic operators appeared by this time, and the meeting was officially closed.

Minutes prepared by:
Ilirjana Isufaj